



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17 dhjetor 2012), nenit 20, të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 34, paragrafit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 05.02.2019 , merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR DHËNIEN E PRONËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË NPL**  
**"HORTIKULTURA", SHA**

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale "Hortikultura", pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është në pjesët kadastrale: nr. 1377-0 me sipërfaqe 7174m<sup>2</sup> dhe nr. 1376-0 me sipërfaqe 42411m<sup>2</sup> të njësive kadastrale P-71914050-01377-0, P-71914050-01376-0, Zona kadastrale Matiçan, me sipërfaqe të përgjithshme për dhënie në shfrytëzim prej 49585m<sup>2</sup>.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është ngritja e fidanishtes dhe serrave, e cila ka për synim prodhimin e fidanëve të bimëve dekorative drunore, materialit fidanor pyjor dhe prodhimin e bimëve zbukuruese.
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është për periudhë afatgjatë për 50 vjet.
- V. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.



- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- IX. Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
- Pjesa grafike nga Plani rregullues “Prishtina e Re – Zona Lindje”,
  - Pjesa grafike nga Plani zhvillimor urban,
  - Kopjet e planit dhe certifikatat e pronësisë.
- X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
14-463/04-26648/19, më 06.02.2019

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

